



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore publike për kërkesën e ardhur në komision nga Shoqata e Unionit të Ekspertëve Shqiptarë dhe Shoqata “MENV Group” për shqyrtimin e disa politikave në dobi të shëndetit.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Elisa Spiropali, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj Floida Kërpaçi dhe Nora Malaj.

Mungojnë:

Bardh Spahia, Klodiana Spahiu, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Vangjel Tavo, Grida Shqina, Halim Kosova, Orjola Pampuri dhe Lindita Metaliaj.

Të ftuar:

Profesor Sazan Guri – përfaqësues i Zyrës Qytetare të Mbrojtjes së Mjedisit

Dr. Mustafa Tola – përfaqësues i komunitetit të Dibrës

Prof. Vasil Murataj – përfaqësues i komunitetit të Mallakastrës për basenin e Poçemit

Ing. Laert Shehu – kryetar i Unionit të Ekspertëve Mjedisorë Shqiptarë

Av. Konti Ilia – përfaqësues i komunitetit të Përmetit për basenin e Vjosës

Gazmend Ponari – përfaqësues i komunitetit të Tropojës për basenin e Valbonës

Besmir Lushaj – përfaqësues i komunitetit të Valbonës për basenin e Valbonës

Azem Parllaku – përfaqësues i komunitetit të Kukësit për basenin e Lumës

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Përshëndetje!

Ashtu sikurse e kemi parashikuar në kalendarin e komisionit, sot kemi organizuar një seancë dëgjimore për kërkesën e ardhur në komision nga Shoqata e Unionit të Ekspertëve Shqiptarë dhe Shoqata “MENV Group”, për shqyrtimin e disa politikave në dobi të shëndetit.

Mirë se erdhët!

Dëgjesa është menduar për sot, sepse sot është edhe Dita Botërore e Mjedisit dhe kërkesa për këtë dëgjese përkonte me problematikat që lidhen midis mjedisit dhe shëndetit. Besoj se kjo ishte mënyra më e mirë për të pasur një aktivitet të komisionit këtë ditë të rëndësishme.

Pa humbur kohë do t’ua kaloj fjalën të ftuarve, të cilët janë: profesor Sazan Guri, doktor Mustafa Tola, inxhinier Laert Shehu, kryetar i Unionit të Ekspertëve Mjedisorë Shqiptarë, avokat Konti Ilia, përfaqësues i komunitetit të Përmetit për basenin e Vjosës, Gazmend Ponari, përfaqësues i komunitetit të Tropojës për basenin e Valbonës, Azem Parllaku, përfaqësues i komunitetit të Kukësit për basenin e Lumës.

A kam harruar ndonjë nga të ftuarit? Jo.

Përpara se t’ua jepja fjalën të ftuarve, doja t’u thosha diçka. Organizata Botërore e Shëndetësisë prej së paku 20 vjetësh ka adoptuar dy qëndrime të mëdha, që njihen me reflektimin e saj në direktivën përkatëse të mjedisit, për shprehjen e të gjitha qeverive dhe ndërtimin e planeve të veprimit të mjedisit dhe të shëndetit. Pra, ka qenë një zhvillim i madh, sepse sa herë që është diskutuar, është folur apo është kërkuar të mbahet qëndrim edhe nga politikat vendore të çdo shteti, gjithmonë kanë prirë planet e veprimit për mjedisin. Siç jua thashë, prej më shumë se 20 vjetësh, planet e veprimit për mjedisin dhe shëndetin konsiderohen si plane integrale, në ankronimet anglisht quhen NEHAP, ku është përfshirë edhe komponenti i shëndetit *health*. Shqipëria e ka përqaftuar këtë nismë dhe në vitin 1998 ka paraqitur strategjinë e parë për shëndetin dhe mjedisin, kështu që jemi plotësisht në hullinë e duhur edhe nga pikëpamja parimore për të folur dhe për të diskutuar për këto gjëra.

Fjalën do të doja t’ia jepja profesor Sazan Gurit.

Ju lutem, zoti Guri, flisni në mënyrë të përmbledhur, pasi materiali që ju keni paraqitur së bashku me kërkesën është në duart e të gjithë anëtarëve të komisionit. Do t’ju lutesha që ato që ju i quani si momente më të spikatura, mund t’i rimerrni, por jo të gjithë materialin në mënyrë integrale, pasi ky material disponohet nga të gjithë anëtarët.

Fjala për ju.

Sazan Guri – Së pari, në emër të grupit që përfaqësojmë, por më shumë të komuniteteve, duke filluar që nga Valbona, Lumi e Kukësit, Vjosa, Langarica, Osumi, Shkumbini e shumë komunitete të tjera, që vuajnë problematikën e asaj që ka filluar prej vitesh, do të doja t'ju falënderoja ju, zoti kryetar, dhe gjithë deputetët e nderuar, për mundësinë që na jepni për të na dëgjuar dhe mbase në një ditë jo shumë të largët do të mund të marrim vendime shumë të mira lidhur me bashkëpunimin: HEC-e, lumenj, komunitet.

Po e filloj në mënyrë të integruar atë që ju keni në tavolinën tuaj, ku Shqipëria si situatë ka këtë gjendje. Aktualisht, sot në Shqipëri janë të projektuara 540 HEC-e, ku gjysma e tyre pothuajse është në zbatim e sipër. E gjithë zona e Shqipërisë Veriore, Verilindore, Lindore dhe Juglindore, që nga momenti ku buron uji, jo vetëm i një lumi, por uji i një përroi, i një ushqyesi tributar, që quhet në gjuhën shkencore, i cili ushqen lumenj të mëdhenj, si: Vjosa, Drini, Osumi, Shkumbini, Erzeni e të tjera, e gjithë kjo pjesë, pra rreth 60% e territorit shqiptar, ndodhet i kërcënuar nga vendosja e HEC-eve. Ligji i vitit 2012, të cilin në gjuhën tonë e quajmë ligji famëkeq, sepse ndryshe nga gjitha rregullat e botës, institucioneve të vendeve fqinje, si: Greqia, Maqedonia, Mali i Zi, por edhe të vendeve të tjera perëndimore apo të botës, bën që në lumë, në qoftë se në një rrjedhë kalojmë 8 mijë litra në sekondë, në lumenj, pasi ndërtohet HEC-i kalojmë 200 litra në sekondë. Në qoftë se kemi një lumë sa gjerësia e dhomës, në mënyrë metaforike, ajo që ngelet është një rrëke sa gjerësia e fletës A4, e cila pothuajse është zero dhe ngelet në lumë, sepse ligji lejon që 2% të lihet në shtratin normal të lumit, të cilën ne e quajmë rrjedhje e Zotit, ndërsa e gjithë rrjedha tjetër prej 98% për 10-11 muaj shkon në tunel, në derivim, në kanal dhe në çdo gjë tjetër, veçse në lumë nuk shkon.

Ne po i bëjmë me dije komisionit tuaj, i cili është Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, efektet, ndikimet jo thjesht në mjedis, pasi fillimisht duket sikur janë në mjedis, në ekosistem, por, në fakt, që të gjitha bien mbi shëndetin publik. Këto HEC-e vijnë kaskadë njëri pas tjetrit. Në momentin që e lë i pari, asnjë metër nuk lihet në rrjedhë, por e merr i dyti, pasi e merr i dyti, asnjë metër nuk lihet në rrjedhë, por e merr i treti e kështu me radhë deri në momentin final, ku uji në rrjedhjen fushore shkon në lumë. Gjithë pjesa burim dhe lumë kryesor, qoftë lumi i Lumës, që është përfaqësues i Kukësit, qoftë lumenjtë e Valbonës, të Dibrës, Lurës, qoftë lumenjtë e Osumit apo të Vjosës, siç është Langarica, të cilin e kemi mbrojtur 4-5 vjet më parë, duke u shpjeguar austriakëve se ishin duke bërë një dëm të pamatshëm, të pallogaritshëm, të cilin kurrë nuk do ta bënin për vendin e tyre... Çfarë bëjmë ne? Nga viti 2008-2010, që ishin vitet për

mbrojtjen e lumenjve nga betejat civile, kaluam në gabime të tjera si dominoja, ku efekti grumbullim u shumëfishua dhe sot ndodhemi në këtë fakt, ku 98% e gjatësisë lumore, ku burojnë Valbona, Bushtrica, Luma, Osumi, Vjosa, Langarica, Bënça, sepse kemi edhe përfaqësuesin, i cili është njëherësh edhe kryetar i Unionit të Ekspertëve Mjedisorë, por edhe përfaqësues i luginës së Bënçës, deri sa derdhen në lum të madh, nuk ekziston më. Pas 1 apo 2 vjetësh, kur të vendosen 540 HEC-e secili në një lumë, përrua apo rrëke, do ta shihni, sepse pikërisht këtë kemi kapur ne si ekspertë, si inxhinierë, që kjo gjatësi nuk do të ekzistojë më me prurje ujore nesër, e para.

60 kanione shqiptare nga më të bukurit në Europë, për të mos thënë në botë, aq sa për kanionin e Osumit dhe të Secës thuhet se, në qoftë se doni të bëni turizëm në guidën *Book* të Milanos, shkoni në Ballkan, por para se të shkoni në Ballkan, shkoni në Shqipëri dhe atje do të gjeni dy kanionet më të bukura në botë, që janë gryka e Secës dhe Osumi. Këto dy gryka që janë 2 nga 60 kanionet që ka Shqipëria, kanion do të thotë dy mure të pjerrëta me ujë poshtë, janë vepra të kategorisë së tretë, shkalla e parë e mbrojtjes, njësoj sikur është kategoria e parë, pra të paprekshme. Pra, të gjitha këto vepra sot preken dhe lihen pa pikë uji, jo me 1 apo 2 litra ujë, po pa asnjë pikë uji dhe askujt nuk i bën përshtypje. Unë ju kërkoj ndjesë, sepse, para se të vinim këtu të gjithë si grup ishim në një takim me ministrin e Mjedisit për Ditën Kombëtare të Mjedisit, ku shprehëm disa mesazhe, të cilat duam t'ua përcjellim qeverisë apo kryebashkiakëve për disa gabime që bëhen ende sot dhe është e pafalshme që këto gabime të bëhen sot kur ekziston kultura, eksperti dhe ligji.

Në fund, dua t'ju them se 98% e gjatësisë dhe 98% e sasisë së ujit merret në mënyrë të derivuar, siç quhet në gjuhën teknike, anashkalon në kanale, në tunele, veçse në lumë nuk është. Çfarë ndodh?

Dikush mund të thotë se po ajo sasi e lumit shkon dhe përfundon në det, por kemi raste kur lumenjtë si Fani dhe Mati devijohen totalisht. Pra, merrni lumin Fan dhe Liqenin e Zi aty ku e kanë rrjedhën dhe ata nuk shkojnë pas X kilometrash në basenin e tyre, por shkojnë në një basen tjetër, i cili do të thotë se ky ekosistem me këtë lloj baseni uji, edhe kur ngelet pak, ekosistemi ekziston, sepse ka një prurje minimale dhe kjo prurje minimale që për 4 muaj duhet të jetë e paprekur, quhet prurje ekologjike minimale. E gjithë bota e projekton në këtë mënyrë, që prurjet minimale ekologjike janë në qershor, korrik gusht dhe mesi i shtatorit dhe këto lihen të paprekura edhe për 10 muajt e tjerë. Atëherë e gjithë kjo sasi lihet vetëm për 10 ditë, 1-10 gusht, sepse kështu është ligji.

Problemet e ligjeve do t'i shohim në një komision tjetër, problemet e ndërhyrjes në mjedis do t'i shohim përsëri në një komision tjetër, por jemi te rasti ku për çdo lumë janë 5 mijë banorë, por nuk jemi të gjithë matematicienë, sepse po aq janë në Shebenikë dhe Librazhd, 5 mijë në Lumë, 5 mijë në krahinën Qinë në Dibër, kurse Valbona shkon 10-20 mijë në pikun e saj turistik. Jo më pak se 5 mijë banorë lidhen me fatin e këtyre HEC-eve, që në pamje të parë duket sikur ne kemi një shtesë energjie, jo shumë 2-3%, shtesë energjie, sepse vendi ynë nuk e ka fare problem që këtë 2-3% që do të marrë nga 540 HEC-et, mund ta marrë jo me këtë prodhueshmëri HEC-esh, as me këtë prodhueshmëri megash, por prapë do të ishte një ekuilibër midis HEC-it dhe mosprekjes së shëndetit publik.

Pse? Burimet që janë fatmirësisht burime kurative, nuk janë burime ujore të thjeshta, aq sa kuotohet në bursë burimi i Sakonikës, që është shpella në Dibër, burimi i Radikës që është në Maqedoni, e cila nuk është mbrojtur nga vendimmarrësit dhe politikanët shqiptarë, por është mbrojtur nga Brukseli, sepse këto ujëra në bursë janë 2 dollarë litri, pasi nuk është si uji që ne pimë, por janë ujëra kurativë. Shumica e këtyre shpella si Saponika nga të dyja anët, Radika, Vjosa, Shebeniku, Librazhdi, Valbona, veç ujit të lumit, marrin edhe ujin e shpellave që është kategoria e tretë, shkalla e parë e mbrojtjes, mirëpo uji i tyre është kurativ dhe njeriu mund të shërohet nga shumë sëmundje që mund të ketë. E para.

E dyta, 30% e ujërave të lumenjve, sepse ne i shohim sikur lumi shkon kot në det, mallkuar ai person apo inxhinier qoftë që mendon se uji shkon kot në det, furnizon të gjithë pusët e banorëve, nuk ka rëndësi të qyteteve apo fshatrave, por 30% e ujit të lumit që ne e shohim të lirë furnizon pusët, me të cilat vadit tokën e bukës, pra prekje direkte e tokës së bukës dhe shëndetit të banorëve. Më kryesorja është që 40 % e këtij lumi shkon në ekosistem. Llogaritet që për 2-3-4 vjetët e para ky lum nuk do të ekzistojë. Për 4 vjetët e para ka 25% të rënies së ekosistemit. 11-12 vjet është cikli i perdubancave diellore, i bie që i gjithë ekosistemi, Lurë, Valbonë, Lumë, Shelbenik, Tomor, Dangëlli, Pronovik, Bënçë, në të gjitha këto ekosisteme, duke qenë se uji sa vjen e pakësohet, për 4 vjet ai është 25% më pak, për 8 vjet të tjera i bie 50% më pak në ekosistem, sepse 40% e lumenjve shkon për lagështi.

I nderuari Niko Pano, oqeanografi dhe hidrologu më i famshëm i Europës, që ne e kishim dhe nuk e dinim, pasi kemi studiuar veprat e tij në detaj, shkruante që 40 % e lumit shkon në ekosistem, do të thotë se shkon në pyll, blegtori, gjë e gjallë, te njerëzit. Njeriu e pëson nga pikëpamja shëndetësore, sepse nuk ka më ujë, nuk vaditet më toka, madje në Dibër kemi pasur

raste, këto 2 vjet që janë ndërtuar HEC-et në Lurë, ku speci nuk zhvillohet normalisht, por po atrofizohet për shkak se ujërat nga poshtë nuk ushqejnë sa duhet rrënjët.

Ne kemi ardhur këtu të gjejmë mbështetjen tuaj, sepse mungon uji nëntokësor, që është baza e produkteve bujqësore, pra e pëson direkt banori. Janë rreth 5 mijë banorë që janë të lidhur si me matematikë me jetën e lumenjve.

Petrani, që është lumi i Langaricës (*tregon hartën*), këtu ka rezervuarin, ky me të kuqe është tunel dhe kanal, 8 mijë litra në sekondë, edhe këtu është 200 litra në sekondë, në fund fare, ku kalon Vjosa, ndërtohet heci 10-16 megavat. Le të themi që HEC-i të marrë... Prurja botërore e përcaktuar energjetike është 33,3%. 33% i lihet lumit, sepse i duhet bujqësisë për vaditje dhe ujitje, dhe 33,3% lumë sasi nuk preket. Ndërsa ne lëmë 1 deri në 2%. Pra, nga 8 mijë litra, 200 litra, i thonë 40 herë më pak, që i bie se edhe ligji aq e lejon. Për të gjithë lumenjtë Valbonën, Bistricën, Lumën, Shelbenikun, është e njëjta skemë. Gjithmonë janë 10 deri në 20 kilometra. Ky është 12 kilometër, por gjithmonë janë 10 - 15, apo 20 kilometra. Lumi diku është 5 kilometra një rrjedhje etj.

1 milion banorë që janë nëpër qytetet Tiranë, Durrës, Korçë kanë lidhje me vendin e origjinës, që kanë një tokë apo bujqësi, pra edhe 1 milion banorë lidhen direkt me këtë që thamë, pjesën veriore, juglindore, lindore, sepse janë 5 mijë banorë për një ushqyes, për një degë lumi, shumëzoi për aq sa jemi ne, i bie minimumi 1 milion, se pjesa tjetër është në fushë. Lushnja, Fieri nuk e pësojnë në mënyrë direkte.

Duke e mbyllur, zoti kryetar, do të doja të theksoja fort atë që po i ndodh shëndetit të banorëve dhe ecures së zhvillimit të bujqësisë, apo perspektivës së tyre nga pikëpamja e agrobiznesit. Uji nëntokësor që nuk e kemi më, uji mbitokësor ai i atmosferës që nuk do ta kemi më.. pastaj, pas shumë kohësh, pas rreth 12-13 vjetësh e pësojnë vetë HEC-et.

Si teknikienë të këtij vendi, nuk po them shkencëtarë, se shqiptarët nuk e pëlqejnë termin “shkencëtar dhe shkencë”, kuptojmë se çfarë mund t’i ndodh kësaj gjëje nesër.

Kjo ishte në përgjithësi përmbledhja që kisha bërë.

Petrit Vasili - Faleminderit, zoti Guri!

Kam një pyetje para se t’ua jap fjalën kolegëve që ju shoqërojnë: nga studimi që i keni bërë situatës, ka disa dokumente bazike, të cilat janë të detyrueshme për zbatim, sepse qeveria shqiptare i ka miratuar dhe ato janë dokumente në fuqi. Cili është raporti i kësaj që keni konstatuar në raport me planin kombëtar të veprimit për mjedisin, shëndetin dhe analizës së tij, që është dokumenti integral që e shoqëron? Pse jua them këtë gjë? Çdo lloj veprimi që ju konstatoni dhe e konsideroni

të dëmshëm, deformon ekosistemin dhe ka pasoja në shëndet. Këto pasoja duhet të jenë afatgjata, vështirë të lexohen si pasoja afatshkurtra, dhe pa diskutim do të jenë të rëndësishme. Në këtë pikëpamje, duhet të jeni sa më argumentues për ta impenjuar qeverisjen gjithnjë e më tepër, duke vënë përballë dokumente, të cilat janë detyrime që i merr vetë qeveria, që ekzistojnë e barten prej vitesh. Ato, përveçse azhurnohen me kalimin e kohës, janë edhe dokumente bazë, për të thënë që këto zhvillime kanë hyrë në konflikt pikërisht me ato norma që ka miratuar shteti shqiptar ndër vite.

Kështu që në rast se ju keni konstatime në këtë drejtim, në rregull; në rast se nuk i keni, nuk ka asnjë problem, por vetëm për të tërhequr vëmendjen tuaj.

Sazan Guri - Në qoftë se më lejon grupi, dëshiroj të përgjigjem unë.

Zoti kryetar, me fjalën e fundit, iu përgjigjet vetë pyetjes që bëtë, sepse ne kemi kapur pikërisht këtë. Zhvillimet e 540 HEC-eve kanë hyrë në konflikt me atë që ka parashtruar shteti shqiptar më parë.

Kur ju thoni raporti i planit kombëtar të mjedisit, aty përcaktohen qartë, zonat e kategorisë së dytë, siç është Valbona, gryka e Sec-it, Osumi. Pra, ato nuk preken. Në komision 4-5 vjet përpara, zotërinj të nderuar, ministra të Energjetikës, janë shprehur: “Nuk thuhet që nuk ndërtohet HEC-i në kategorinë e dytë, në Valbonë, në Osum apo Vjosë”, madje kemi qenë në një sallë të tillë, me profesor Frashërin në krye dhe 5 shkencëtarë, si dhe zotërinë ministër të asaj kohe, zotin Genc Ruli, i cili tha: “Më gjeni në ligjet shqiptare” – ku të thuhet “nuk ndërtohet HEC”. Në fakt, në ligjin shqiptar thuhet: “Nuk lejohet të ndërtohen shpella, ura, me gurë, beton”, pra këto janë të gjitha elementet që ndërtojnë HEC-in. Janë aktet nënligjore që zbërthejnë se cilat ndërtohen, jo ligji.

Shkalla e parë e mbrojtjes do të thotë hyn vetëm studenti me një profesor dhe mban shënime. Kjo është shkalla e parë e mbrojtjes. Ka edhe një zonë buferike që preket, shkalla e parë e mbrojtjes që është 200 metra. Sapo është bërë ekspertiza nga një grup, në gjyq që jemi ne, zoti Laert ka bërë një ekspertizë, ku thuhet se kjo shpellë me ujë kurativ e ka distancën 200 metër për të mos u prekur. Ai shkon ndërhyr pikërisht ke 50 metërshi, pra 150 metër i prekur. Nuk e dimë se si do të dalë në këtë ballafaqim të arsyes dhe mosarsyes në këtë proces gjyqësor, por kërkojmë ndihmën tuaj si njerëz të zgjedhur dhe fort të nderuar që përfaqësoni komisionet, veçanërisht tri komisioneve, tuajin që goditet shëndeti publik, pastaj te Komisioni i Ligjeve, që të goditet ai ligj fatkeq dhe famëkeq, pastaj te Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, ku do të shohim se si preken... Për shembull, m’u kujtua, lumenjtë tanë janë standard i lartë, që do të thotë lumenj të egër, nga më

të bukurit në Europë, e thotë edhe Parlamenti European. HEC-et tona i kthejnë këta lumenj, zoti kryetar, në qoftë se është standardi i lartë, nota 10, as në nivel të mirë, që i bie nota 8-9, as në nivel të moderuar që i bie 6-7, as në nivel të keq që i bie 5-6, por e kthejnë lumin jashtë klase. Pra, nuk është se ma preku mjedisin dhe unë do të shqetësohem, dua zhvillim ekonomik dhe dakord, ndërsa ne kemi vërtetuar që nga standardi që kanë lumenjtë tanë, kalojnë në standard jashtë klase se të kishte ngelur në klasë, nota 4-5, do të përpiqem ta përmirësoj, do të marr një notë kaluese, por jo, janë jashtë klase. Ky është konflikti. Kur më prek këtë standard, do të thotë se ke prekur shëndetin e banorëve që argumentuam.

Petrit Vasili - Faleminderit!

Fjala për zonjën Bode.

Edlira Bode – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit që keni ardhur gjithë të ftuarit!

Pranoj padijen time në këtë fushë, nuk kam shumë informacion. Kam një profesion tjetër dhe ka pak kohë që jam deputete, por u bëra shumë kurioze nga fjala juaj kur thatë që në botë shfrytëzohet 33% e lumit, 33% i lihet bujqësisë dhe 33% pjesës tjetër, në rrjedhën normale, ndërkohë që ne lëmë vetëm 1 ose 2%. Këtë gjë ne e lejojmë me ligj? Kemi një ligj të tillë që na lejon ta prekim 98% të lumit?

Faleminderit!

Sazan Guri – Është ligji nr.111 “Administrimi i burimeve ujore”, neni 39, germa “d”. Ligji është i shkëlqyer, ligj european, se ne ligjet i transpozojmë në shumicën e rasteve, pikërisht vetëm një rresht duam të godasim.

Kemi 6 muaj që i lutemi zotit Ulsi, të cilin sapo e takuam, ndoshta u bë edhe xheloz që i thamë se po shkojmë te Komisioni i Shëndetësisë, të ndryshojë atë rresht të mallkuar të ligjit, ku thuhet: “lumenjve, shtretërve u lihet “Q-ja” e 10 ditëve dhe u merret “Q-ja” e 355 ditëve”. “Q-ja” është debiti, pra debiti i 355 ditëve, minimalja merret dhe ajo e 10 ditëve duke filluar nga 1 deri në 10 gusht, mesatarisht lihet. Tani ç’bëjmë? E lëmë për të gjithë vitin kaq. Në qoftë se e lë jo 8 mijë litra, por 200 litra, kjo 200 litra nuk prodhon më ujë për puset, ekosistemin, për lagështinë, se harruam të thoshim se ky ujë i lagështisë, në qoftë se vjen reja e mbarsur nga Drini, Vjosa apo deti, në qoftë se nuk ekziston lagështia në një zonë të caktuar, atëherë nuk bie shi, ndaj themi që mbas 10 vjetëve, pikërisht prodhuesit do ta vuajnë vetë, ai rri në Bruksel, luan bingo, fitimin e fut në energji rrjet dhe e pësojnë tri vetë. Harruam të thoshim që 540 HEC-e shumëzim 3 persona, nëna, babai dhe djali, aq punëson HEC-i i thonë 1500 veta, ndërsa po t’i kishim turizëm, le të thotë zoti

Kasmet, i thonë 20 mijë, 200 krevate, një krevat ka 4 të punësuar, pra, i bie 800 të punësuar vetëm në Valbonë. Mora minimalen. Pra, shikoni sa ndryshim ka edhe punësimi, pavarësisht se jemi te shëndeti në këtë rast dhe po i lëmë këto të tjerat. Ky është ligji, lë debitin e 10 ditëve dhe pikërisht ky është 2%. E kanë llogaritur shumë mirë. Ligji u bë pasi morën 250 HEC-et. Mirë atëherë që ligji u ndërtua gabimisht, sepse hasi...po kur erdhi qeverisja aktuale në vitin 2013 apo në vitin 2017... Në këtë përpjekje që po bëjmë, pse të mos dëgjohemi, se po vërtetojmë që bota lë 33 % pa prekur, pra quhet prurje minimale ekologjike. 15 qershor-15 shtator, e paprekur, ndërsa bujqësia e shkëmben. Me të vërtetë energjia është 33%, por bujqësia kur është shi i thotë: “me leje, mund ta marr unë këtë ujin tënd, sepse më duhet energjia, ndërsa ti ke shi nga natyra”, “Si urdhëron!” – thotë ai dhe e merr. Pra, energjia shkon nga 38 deri në 66%. Kaq merret në të gjithë botën. Pastaj kemi rastet kur vërtetojmë, siç jemi në gjyq tani, që gjithë peshku që vjen nga Ohri, para se të shkojë në Bunë, ngjitet lart, bien 200 peshq troftë, shumohen 2 milionë në një shpellë a në një vend, që quhen rrasat dhe nga aty dalin 2 milionë që furnizojnë gjithë... Kur ia shpjegua gjyqtarit, me të vërtetë duket peshk, e hëngri nuk e hëngri banori, jo sepse ky peshku mjafton të këpusë një hallkë, por dëmi që në fillim është 1 njësi, shkon 2 mijë njësi te njeriu. Profesor Petriti e kupton shumë herë më mirë këtë dëm akumulativ. Pra, dëmi 1 njësi, që mungon ky peshku në zinxhirin andej nga fillimi i jetës së njeriut, kur vete te dëmi që nuk është ajo që do hajë peshku, nuk është ky që do të hajë këtë e me radhë, te njeriu vete një dëm, e kemi bërë edhe në foto, dëm sa gjatësia e njeriut. Pra, dëmi te peshku do të konsiderohet sa një majë thoi, kurse te njeriu do të konsiderohet sa gjatësia e tij.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit!

Kush e do fjalën?

Po, zoti Tola.

Mustafa Tola – Faleminderit shumë, sepse jeni komisioni i parë që na hapët rrugën të themi mendimet tona dhe të shprehim shqetësimet e banorëve të komunitetit të Dibrës, për Setën, në rastin tim, dhe të gjithë komunitetit të shqiptarëve që interesohet, që është i dëmtuar nga ndërhyrja e HEC-ve, të cilat po sjellin një ndryshim thelbësor në ekosistemin shqiptar!

Ndryshimi thelbësor në ekosistemin e natyrës sjell pasojat të parikuperueshme, që duhen vite të ndryshohen, ose mbeten edhe të pandryshuara.

Unë gjej rastin të falënderoj edhe një herë kryetarin e komisionit, zotin Vasili, që na dha mundësinë, së paku, të themi ato që ndiejmë dhe ato që ndeshim në terren!

Unë përfaqësoj luginën e Setës, por si Seta janë të gjithë lumenjtë e Shqipërisë. Ky është rasti tipik, që është analog ndoshta me shumë raste të tjera.

Seta është një luginë me gjatësi 13,7 kilometra, nga ku, deri tani, 9,5 kilometra kanë devijuar në kanale, në tunele dhe në tuba. Deri tani bëhet fjalë për një devijim për 4 HEC-e. HEC-i i 5-të, për të cilin ne jemi në proces gjyqësor, është në pjesën fundore të lumit, pjesa më dinamike dhe më e bukur e këtij lumi. Kjo pjesë fundore devijohet me 5 kilometra të tjerë, jo me kanale apo tunele, por totalisht me tubacione dhe tunele, me devijim total të rrjedhës deri sa derdhet në Drinin e Zi. Kjo do të thotë se i gjithë lumi, prej 13,7 kilometrash, vdes, nuk ka jetë. Pra, i merret jeta një lumi në mënyrë barbare!

Nga të gjithë parametrat teknikë, që foli edhe profesor Sazani, dua të kujtoj se kjo prekje do të sjellë pasoja shumë të rënda, sepse mungesat në reshje dhe ndryshmi i klimës do të jenë dramatike. Profesor Sazani tha se 40% e lagështirës vjen nga deti dhe 60% është lagështi lokale. Nga 60%, 40% transferim vjen nga lumi dhe 20% transferim vjen nga bimët. Këto janë dy koncepte, që bimët dhe pyjet e transferojnë lagështirën. Kombinohen 60%-shi dhe 40%-shi dhe bie shi në luginë. Nëse mungon 60%-shi, era i merr retë, i çon diku tjetër dhe nuk do të këtë më shira.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sigurisht, krijohen energjitë negative dhe pozitive dhe ndodh shkarkimi. Pra, era i merr retë dhe i çon diku tjetër. Mungesa e reshjeve të shiut dhe të borës do të sjellë pasoja te bimët, te pyjet, të natyra në përgjithësi, te kafshët, gjallesat e egra, brenda dhe jashtë lumit, ndryshon i gjithë ekosistemi, ndryshojnë edhe temperaturat në territor, sepse nuk do të ketë prurje me temperatura minimale, që shkojnë nga 6 deri në 8 gradë, që ka Seta, por do të shkojnë 15 deri në 20 gradë, pasi ka pak ujë në lumë dhe ka një përmbysje totale të ekosistemit.

Ne nuk jemi kundër HEC-ve në total, sepse Shqipëria ka nevojë edhe të zhvillohet. Zhvillimi duhet të ndodhë, por me parametra teknikë të pranueshëm. Për shembull, në konfliktin e përdorimit të pasurive kombëtare ka një rregull, që deri në 10% të pasurisë, sepse edhe lumi Seta është pasuri kombëtare, siç janë Valbona, Osumi, Vjosa, ose siç është një minierë. Të gjitha këto do të përdoren në dobi të njeriut dhe ka një përqindje të caktuar. Deri në 10% quhet përdorim, 10-25% quhet keqpërdorim, 25-50% quhet shfrytëzim, 50-75% quhet shfrytëzim barbar dhe 75-100% quhet shkatërrim. Në rastin e Setës nuk jemi as te keqpërdorimi, as te shfrytëzimi, as shfrytëzimi barbar, por te shkatërrimi i lumit. Nuk devijohet dhe vdes 75% e pasurisë kombëtare, por ndodh që vdes 100% ajo pasuri. Kjo është e tmerrshme. Unë nuk e kuptoj, si mund të tjetërsohet kështu

pasuria? Si mundet që teknikienët tanë të pranojnë projekte deri në këtë shkallë? Politika nuk ka shumë faj, se ndoshta nuk i di disa gjëra, por kjo që po ndodh te HEC-et në Shqipëri është me të vërtetë një katrohurë, pasojat e të cilave do t'i ndiejmë pas disa vjetësh dhe këtë e tha shumë qartë edhe profesor Sazani.

Unë kam para një ekspertizë të ekspertes së mjedisit për Setën, e cila mjafton për të kuptuar dëmin mjedisor që i shkaktohet Setës dhe sa e rëndë është pasoja që vjen nga ky lum. Se cili do të jetë qëndrimi i gjykatës, është punë tjetër. Unë nuk e kuptoj se si gjykata mund të mos i respektojë ligjet shqiptare dhe të mos na japë drejtësi. Ne besojmë se do ta gjejmë drejtësinë në gjykatë, duke menduar se do të respektohet ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund ta lexoj shkurt: “Projekti, që propozohet të kryhet, konsiderohet me dëme të mëdha në mjedis, ku një pjesë e mirë e dëmeve që shkaktohen janë të pakthyeshme. Ky projekt shoqërohet me dy lloj dëmsh negative: ndikime negative të përkohshme, që nënkupton se mund të rikuperohen, dhe ndikime negative të përhershme, që nuk rikuperohen më. Dëmi kryesor i përhershëm është i pakthyeshëm. Nga funksionimi i këtij HEC-i konsiston në devijimin e rrjedhës ujore të përroit të Setës nga shtrati natyror i tij dhe futja në tubacione, që do të përshkojë një gjatësi prej 5,1 kilometrash për t’u derdhur në lumin Drin. Ky devijim, me sasi të mëdha të prurjeve ujore, çon në shkatërrimin e lumit”. Unë mund t’ju them, pa e lexuar ekspertizën deri në fund, sepse është shumë qartë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk preken jo vetëm zonat e mbrojtura. Janë shkelje të tjera ligjore, por po janë thjesht dëme mjedisore. Dëmet e mjedisit janë drejtpërdrejt dëme në shëndet. Para se të them dëmet në shëndet, po ju paraqes dy pamje me interes, që i kanë bërë ekspertët në terren.

(Paraqet pamjet.) Këtu është një pamje e Soponikës, një ujëvarë prej 200 metrash, e shpallur “Monument natyre”. Për çudi nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Zyra Rajonale e Zonave të Mbrojtura në Dibër, i vetmi territor prej 2 dynymësh, pjesa që është në burim, shkëmbi sipër dhe e gjithë ujëvara është lënë jashtë monumentit të mbrojtur. Unë çuditem si ka ndodhur kjo gjë, sepse nuk është gabim, por veprim i qëllimshëm. Edhe sikur të mos preket drejtpërdrejt monumenti, preket zona buferike e monumentit, e cila mbrohet njëlloj me ligj. Kjo është një zonë e paprekur, 200 metra kanë mbrojtje jashtë zonës, jashtë monumentit.

Jashtë kësaj ujëvare janë edhe dy fotografi shumë të bukura që kanë bërë ekspertët këto ditë në terren, një foto tjetër e lumit Seta, që është vepra e parë e madhe. Po ta shikoni nga afër,

është lum i kthjellët, transparent, me ujë që pihet në çdo vend, jo vetëm në burim, por deri në derdhje. Është e tmerrshme që ky lum, i cili është burim derisa derdhet në Drin, të futet në tubacione dhe të vdesë. Kjo pikë është brenda zonës së mbrojtur, sepse është zonë buferike e një monumenti të tillë natyre, megjithëse është bërë një përpjekje e çuditshme. Këtu duhet të ndërhyjë prokuroria, por nuk e di nëse do të ndërhyjë, për ta çuar në vend drejtësinë dhe kjo është temë tjetër? Pra, është devijuar edhe zona e mbrojtur.

Për të kaluar te dëmet në mjedis, uji është vetë jeta dhe ka ndikim thelbësor në shëndetin e njerëzve. Ndryshimet e balancave që thashë më sipër ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e njeriut, sepse ndryshojnë të gjitha elementet përbërëse të ajrit, të natyrës, të bimësisë, të lagështirës. Ato ndikojnë jo vetëm drejtpërdrejt në shëndetin e njerëzve, por edhe indirekt në uljen e të gjitha prodhimeve bujqësore dhe blegtorale në territor. Përderisa do të kemi më pak bimësi, më pak zhvillime bujqësore, do të kemi më pak prodhime blegtorale dhe kullota në territor. Do të dëmtohet shumë rëndë pjesa turistike e zonës, sepse në 1 kilometër gjatësi lumi, ka 3 monumente natyre fantastike.

Një ekspeditë spaleologjike bullgare, me 25 studentë dhe pedagogë, kanë ndenjur dy javë në çadra në fshat dhe kanë eksploruar shpellat si mrekulli natyrore të rralla, kurse ne nuk i ruajmë dhe nuk mbrojmë, sepse na duhet një artificë ligjore që t'i përjashtojmë edhe nga zona e mbrojtjes.

Ka shumë gjëra për të thënë dhe ndoshta po ju lodh. Disa gjëra mund t'ju duken të pakuptueshme ndonjëherë, por ndikimi është aq i madh, sa edhe bleta në atë territor do të ketë më pak prodhueshmëri mjalti, sepse pa lagështi ajrore nuk bie vesa dhe bleta nuk ka mundësi të marrë polenin dhe nektarin e luleve. Nuk është vetëm kjo, por do të ketë më pak prodhime të tjera në tërësi në territor.

Shkurt, jeta e Setës është jeta e banorëve dhe unë nuk di çfarë ndihme mund të na jepni ju, por do të ishte kënaqësi për ne që dikush nga ju të vinte dhe ta vizitonte atë vend dhe të krijojë përshtypje direkt në terren për ato që ne themi këtu, nëse janë të të plota apo të mangëta, sepse ndryshe nuk ia dalim dot, me të gjithë përpjekjet që po bëjmë me komunitetin e banorëve të fshatit Çidhën dhe Arrëz.

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Tola!

Po, zonja Bode.

Edlira Bode – Ideja ime për një HEC është se ndërtohet një liqen që mbledh ujin, ky ujë shfrytëzohet nga diga dhe pas digës rrjedh sërish.

Mustafa Tola – Jo, nuk është ashtu.

Edlira Bode – Ma shpjego!

Mustafa Tola – Uji merret në tri burime të ujit të pijshëm, që duhet të ishin evidentuar si ujë i pijshëm me 150 litra ujë në sekondë, dhe i gjithë lumi të ketë ujë të pijshëm, futen në tubacione 2 me 2, futen në tunel nën tokë 5 kilometër dhe lumi vdes totalisht.

Sazan Guri – Shkurtimisht kemi dy variante.

E para, zonja deputete, ndërtohet një digë, siç kemi HEC-in e Pocemit, duke pushtuar toka buke shumë të mëdha. Pra, ndërtohet një rezervuar i madh. Aty ka një lartësi, siç është Fierza, Komani e të tjerë.

Variantet tona të HEC-ve të vegjël, 10, 8, 2, 1 dhe ndonjëherë edhe gjysmë megavati, janë që ky lumë, i cili rrjedh siç e ka krijuar Zoti, merret me anë të derivimit, me një kanal, me një tunel, me një tub (keni edhe një pamje që futet në tub), futet në tub dhe në momentin që jep energji të caktuar në një pikë të caktuar, sapo derdhet në lumë, pa ecur 1 metër, e merr tjetri. Pra e bën një tjetër biznes. Ku buron kjo gjatësi?

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk riciklohet, se shtrati i lumit është pa pikë ujit. Pra, ky ujë futet në tub dhe kjo do të thotë peshku nuk jeton më, ekosistemi nuk jeton më, ujërat nëntokësore...

(Diskutim epa mikrofon.)

Petrit Vasili – Më falni, mos ndërhyini, se nuk verbalizojmë dot asgjë. Merreni mikrofonin dhe flisni me radhë, sepse përgjigjet e profesorit duken sikur janë jashtë kontekstit.

Po, zoti ...

Arben Kamami – Faleminderit!

Unë i dëgjoj me shumë kënaqësi të gjitha emisionet tuaj dhe gati-gati bëhem pjesëmarrës në to, por mendoj ta ulim pak nivelin e diskutimit në mënyrë më prozaike.

Dëmi mjedisor dhe përfitimi ekonomik në rang kombëtar, duke bërë krahasimin, me aq sa mbaj mend, para viteve '90, ¼-ta e prodhimit të energjisë elektrike prodhohej nga hidrocentralet e vegjël. A keni arritur te ky nivel, apo jo?

Së dyti, unë vij nga Elbasani, një qytet që ka pasur dikur Kombinati Metalurgjik me rreth 12 mijë punonjës, ku realisht më shumë se një e treta e familjeve kishin një përfaqësues apo punonjës atje. Sot në Elbasan bëhet një diskutim i tillë në ambientet ku diskutohet, jo në ato ku nuk diskutohet, dëmi ekonomik që u bë nga shkatërrimi dhe mbyllja e Kombinatit Metalurgjik dhe dëmi social është shumë më i madh sot sesa dëmi mjedisor dhe ai shëndetësor. Duke bërë këto dy krahasime, nuk është thjesht imi, nuk jam aq i mençur, dëgjoj edhe diskutimet që bëhen sot në

Europë, a do të zhvillohen vendet e prapambetura apo jo? A do të zhvillohet Afrika, a do të zhvillohet Shqipëria, apo jo?

Petrit Vasili - Faleminderit, zoti Kamami!

Zoti Guri, situata sot rëndohet më shumë për një arsye shumë të madhe. Ju e dini që në vitet 1995-1996 Shqipëria është përballur me fillesat e shkretirizimit, i cili ka qenë një fenomen, që do të ishte shkatërrues për Shqipërinë. Një situatë e tillë kaloi pa ndonjë ndërhyrje shtetërore dhe kjo dihet, por natyra ndihmoi në atë rast dhe përveç humbjes së pasurisë ujore, përveç zvogëlimit shumë të madh të pasurisë pyjore, që janë edhe ato mushkëri të Shqipërisë, duhet të tërheqim vëmendjen se tendenca që ka qenë evidente përkohësisht u kalua, por rreziku është eminent për shkretirizim dhe besoj se është një efekt i amplifikuar me këtë që ju ngrini sot. Kjo duhet të evidentohet qartë që zhvillimet brenda pak viteve mund të jenë shumë të shpejta, të rrufeshme në planin negativ edhe për arsye të erozionit të madh, edhe për shkak të humbjes së një pasurie të gjelbër, e cila humbet në vazhdimësi. Ajo që humbet dhe ajo që rikuperohet janë në disproporcion, në disfavor të hapësirës së gjelbër. Kjo ishte vetëm për të lidhur efektet, se nuk jemi duke folur për ato që ndodhin brenda një jave apo 24 orëve, por janë efekte me shtrirje në kohë. Pastaj lidhur me shëndetin efektet janë edhe më të mëdha.

Flamur Golemi - Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj së pari pjesëmarrësit, në veçanti profesor Sazanin, pasi edhe unë jam ndjekës dhe simpatizant i tij. Edhe për shkak të profesionit që kemi në këtë komision jemi shumë afër mjedisit dhe në parim të gjithë jemi dakord, se jemi pjesë e kësaj kauze.

Ndërkohë që po ju dëgjoja, para 10 vjetësh rastësisht me disa miq të mi mjekë në Janinë, më ftojnë për të bërë raftin. Nga mesi i lumit unë kuptova që kisha të bëja me Vjosën. Lumi i tyre Aosi, më i pastri, më i kthjellëti, më i bukur, me shpellat, një resort shumë i madh për pjesën e zhvillimit të turizmit të gjithë asaj zone, pjesa e Kallpaqit deri në breg dhe në afërsi të kufirit Tre Urat. Më vonë kuptova se çfarë i kishim bërë natyrës. Kur u ktheva sërish në Gjirokastrë duhet të përballesha me faktin që bashkëjetuesi sot i një zëri shumë të fortë opozitar duhet të bënte në kaskadën e lumit Kardhiq 5 hidrocentrale. Tani po e kuptoj me atë çfarë thatë se çfarë do t'i bënte atij lumi. Shans i madh, paska dashur Zoti, me thënë të drejtën, sepse i merrni koncesionet për t'i dhënë me nënkontraktorë të tjerë, sigurisht sot e kësaj dite nuk janë bërë.

Si mjek jam pranë akuzës suaj, por si përfaqësues i popullit ajo që u tha edhe nga doktori më parë, për pjesën e zhvillimit ekonomik dhe rritjes ekonomike, ka nevojë për zhvillim dhe për t'u bërë edhe HEC-et. Përpos ndryshimeve në ligj, që në parim do të jem gjithmonë pjesë e

kauzës për të mbrojtur lumin Vjosë, do të doja mendimin tuaj edhe si profesionist, edhe si ekspert i mjedisit, nuk e di nëse edhe në fushën e energjetikës, sot në vendin tonë, cilat do të jenë me më pak kosto në mjedis, edhe për zhvillimin ekonomik: energjia e rinovueshme, HEC-et, pjesa e energjisë diellore apo ato të erës? Cilat mendoni ju se mund ta zhvillojnë ekonominë dhe mund të japë më pak ndikim në mjedis?

Petrit Vasili - Po, zoti Guri.

Sazan Guri – Lidhur me pyetjet që bëtë, që një e katërta e energjisë së vendit është siguruar nga HEC-et e vegjël para '90-ës, mendoj se në atë kohë kemi pasur të bëjmë me pjesën më të mirë të mundshme të shkencës. Kanë qenë vetëm 83 HEC-e. Gjithë kjo energji potenciale, se lumi aq sa e shikon, aq mund të prodhojë, nuk është ashtu, sepse kanë qenë shumë të mençur. Ndjesë pastë Farudin Hoxha me shokë që thanë se në Shqipëri bëhen 83 HEC-e, të cilat u rigjeneruan në vitet 2007, 2008 dhe 2009 dhe u kërkua të bëheshin edhe 83 të tjera, deri kaq mund të mbante ky vend. Nga 150-160 HEC-e sot jemi te 540 HEC-e. Jemi në një numër shumë të lartë rendor, sasi, sepse ato HEC-e atëherë nuk jepnin siç ju mendoni, një të katërtën, absolutisht 1500 megavatë që jepnin vetëm kaskadat e lumit Drin dhe HEC-et jepnin deri 1%. Ndërsa zoti Negovani dhe ai ndjesë pastë, shkencëtar i madh shqiptar thoshte se maksimumi i të gjithë HEC-eve mund të japë 2-3 % të energjisë së vendit. Të gjithë HEC-et në mënyrë potenciale, sikur t'i futësh të gjithë në punë, që në fakt nuk futen dot në punë, se edhe toka 100 tonë naftë ka, si inxhinier gjeolog projektues që jam, por 7 tonë i merr tokës, deri në 20 tonë me metodat e dyta, nuk të jep më tepër natyra. Zoti nuk të jep më tepër se i duhet tokës ajo naftë për të prodhuar naftën tjetër për të mbajtur dhe shtresat e tokës. Edhe lumin kur e shikon, shikon 100 litra në sekondë, 100 tonë, por nuk ia marrim dot të 100-at siç ia marrin këta, por do t'i marrësh edhe të bësh biznes, t'i gëzosh, 5 HEC-e 4 t'i gëzosh, 4 i bie 75%. Këtë të fundit që kërkon të shkatërrosh edhe veten edhe mua, veten nuk e kupton se je i babëzitur. (këtë po themi me shkencë) do ta kuptosh pas 11 vjetësh. Ne po të themi se çfarë të ndodh ty dhe çfarë më ndodh mua sot, çfarë i ndodh vendit, ligjit, fëmijës tim sot, bujqësisë, lagështisë e të tjerë. Kjo është përgjigjja që llogaritja ekonomike është e tillë. Ne jo rastësisht kemi marrë me vete llogaritjen e kostove. Këto janë module dhe formula të llojit amerikan anglez se vetëm ata bëjnë shpikje, por ai që di anglisht dhe ai që ka kurriz për t'u ulur për të punuar, i zbulon si anglezi, gjermani, italiani, ne nuk kemi diferenca shkence me italianët, madje ne i udhëheqim shpeshherë ata. Pikërisht pse jemi popull i vogël, na thonë: “Rri aty, boll e ke 2 %”. Kështu themi ne që arkitekturën e Tiranës e kanë bërë italianët. Jo e ka bërë Qemal Butka, ai dibrani me atë çekiçin

që e morën në Romë. Ai i shkreti mori 2%. Kështu edhe puna jonë sot. Këto llogaritje thonë që njihet me mënyrën sesi po projektohen, e kanë matjen 1 me 8, 1 milion euro të hedhura bëjnë 8 milionë euro gabim. Kjo ka rezultuar me module, me formula.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur është HEC-i i gabuar.

Futet qepa, speci, ajo llixha e Bënjës...

Na doli tani që për ujin në Liqenin e Zi në Gramsh është uji më i mirë në botë, nuk ka nevojë të shkohet te doktori, e nxori para 3 ditësh, sepse ka lëndë radioaktive që ti shkon 7 minuta vetëm një muaj në vit. Ti shkon e prish Liqenin e Zi. Dua të them diçka tjetër për një gjyqtar që është nga ky liqen, qan, se po shkatërrohet Liqeni i Zi në Martanesh. Ai qan me intuitë, unë qaj me shkencë. Në atë liqen vetëm nga datat 1-30 gusht mund të futësh këmbët për 7 minuta, sepse më tepër nuk qëndron dot. Ti ke marrë lëndë radioaktive dhe je i shëruar, nuk ke nevojë të shkosh te doktor Petriti.

Dua të them për rëndësinë që ka, por fakti që Radika është 2 euro shishja në Bursë, edhe Valbona, edhe Seta nuk është rastësi, sepse 500 lekë është shishja, por ky ujë është kuotuar kaq. Nuk është rastësi se janë ujëra kurativë. Kjo është llogaritja ekonomike.

Për fenomenin e shkretirizimit, zoti Vasili keni shumë të drejtë. Ju e dhatë vetë përgjigjen, pasi keni punuar në fushën e shkencës vetë, pra nuk kam çfarë të përgjigjem. Pasuria e gjelbër kërcënohet, sepse kjo pasuri e gjelbër që sot është në këtë gjendje për shkak të lagështirë, nesër kjo lagështi mungon, nuk e furnizon shiu.

Kjo përmbetje që vjen në Shkodër sot, 14 mijë hektarë që është baseni i Drinit, 14 mijë metër katrorë, 100 hektarë të 1 milionë e 400 mijë hektarë, 1 hektarë ka 600 pemë, 1 pemë mban 300 litra, atëherë shiu që bie në Dibër, në Kukës do 10 ditë të shkojë në Shkodër. Për shkak të erozionit shkon për 1 orë, sepse mungon pema, e cila mbante 300 litra për pemë dikur. Sot nuk mban më. Kemi bërë një eksperiment në një emision televiziv, morëm ujë e derdhëm, ku nuk kishte pemë dhe shkoi për 1 orë në Shkodër. Po të vendosim sfungjerin, që është humusi apo pema, ky ujë nuk shkon fare në Shkodër. Kjo është ajo që do të ndodhë dhe është përgjigja e pyetjes suaj.

E fundit, në lidhje me pyetjen për Karidhqin, se cila është pjesa më e mirë e alternativave të energjisë, do të thosha se është ekuilibri, që do të thotë kaq përqind: 3, 4 dhe 5 energji diellore edhe panele, por edhe disa bimë bujqësore të ulëta: grurë, tërshërë. Shkenca ka plot të tilla. Jo në kodra që janë turistike dhe arkeologjike, por siç ka e gjithë bota: mullinj ere, ferma ere,

3%, por edhe gjeotermia ku Zvicra e ka 12 gradë dhe e kthen në 28 gradë energjinë termike për të ngrohur banesat. Ne e kemi 18 gradë dhe e kthejmë kollaj në 27 gradë për përdorim të brendshëm. Biomasa që mund të çojë në një djegës termik nuk është rikuperim i energjisë, aq për qind sa i lejohet një djegësi termik. Të gjitha këto bëjnë një koeficient që të kemi ujin 70-80% dhe pjesën tjetër e zëvendëson me alternativat. Ekuilibri i tyre prodhon energji. Pjesa tjetër, që ti je i çekuilibruar fillon dëmi, që është 1 me 8. Në këtë kuptim mendoj se alternativa më miqësore janë kur ti i bën të gjitha. Dikush ka termoenergji si Kosova dhe Greqia. Ne kemi 80 % energji ujore, por nuk mund ta bësh 100 ose 101 % energji ujore, të shtosh HEC-e të mëdhenj kaskada, të shtosh edhe Skavicën, Ashtën, të bësh edhe HEC-e të vegjël që mbyll jetën e njeriut. Këtë po them. Në 500 HEC-e ne themi 100- 200- 250 po e rris. Ti gëzosh! Por në këto 250 nuk do të marrësh 100% ujë, por do të marrësh 33% plus sasinë e bujqësisë që shkon 66%. Katër muaj: qershor, korrik, gusht dhe shtator do të ma lësh të gjithë vitin, ndërsa ai ma merr këtë sasi dhe ma lë zero, atëherë kjo është ajo që si teknikienë kërkojmë dhe luftojmë.

Petrit Vasili - Nga të ftuarit ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar? Ju lutem, në mënyrë të përmblodhur, sepse edhe ju vetë keni një aktivitet në orën 12:00.

Laert Shehu - Po, do të flas shkurtimisht. Unë jam kryetar i Unionit të Ekspertëve Mjedisorë, jam inxhinier mjedisi.

Desha të shtoj se fakti që jemi në këtë gjendje sot nis me një studim në rang kombëtar për projektet dhe planet e qeverisë për dhënien e koncesioneve, ku para se të jepen këto koncesione, para se të fillojnë projektimet, investimet e subjekteve, duhet të bëhet një studim në rang kombëtar, një vlerësim strategjik mjedisor, dhe një hartë se ku mund të jepen dhe ku jo këto hidrocentrale, duke përjashtuar zonat me vlera turistike, si ato të ekoturizmit malor, turizmit bregdetar apo zonat e mbrojtura që janë me status ligjor të mbrojtur. Pas kësaj çdo vepër, çdo projekt, çdo koncesion, objekt koncesioni ose jo me autorizim të thjeshtë duhet t'i nënshtrohen një studimi të thelluar specifik për ndikimet në mjedis. Ndikimet në mjedis kryhen nga ekspertët, nga një grup ekspertësh më saktë dhe jo nga një siç ka ndodhur rëndomë deri sot. Ky grup ekspertësh kryen një vlerësim të ndikimeve negative dhe pozitive në mjedis të projektit. Eksperti duhet të jetë i drejtë në vlerësimin dhe në gjykimin e tij si simboli i gjykatës që është peshorja, ku peshohen efektet negative dhe pozitive. Në momentin që peshorja anon nga efektet negative, atëherë duhet t'i themi jo këtij projekti. Në momentin që ajo anon nga ana pozitive, atëherë duhet t'i themi po. Në parim, ne nuk jemi kundër hidrocentraleve, se janë një nga burimet e rinovueshme të pastra të prodhimit të energjisë, por të bëhen me studime të mirëfillta dhe me

kritere. Është ajo që tha edhe profesor Sazani, se nga pesëqind të dhëna, po themi se dyqind apo deri në dyqind e pesëdhjetë janë të tolerueshme nga ana jonë, kur nuk prekin zonat e mbrojtura, kur një grykë apo në një luginë janë pesëmbëdhjetë kilometra të hiqen dhe pesë, pra, të ketë edhe një shpërndarje gjeografike të dhënies së këtyre koncesioneve. Të ketë edhe studime për hidrobiologjinë, pra për botën e gjallë që ndodhet brenda këtyre burimeve ujore. Asnjë studim deri më sot, përveç këtyre të mëdhenjve, siç është ai i Banjës apo i Kalivaçit, që mund të kenë studime për peshqit apo mikrogjallesat e ujit, H/C-et e vegjël, të cilët kanë arritur deri në 0, 4 – 0, 5 mega prodhim për hidrocentral; kapacitet prodhues qesharak, që të mund të ndërtohet një H/C për 0, 4 apo 0, 5 mega. Domethënë, s'ka asnjë lloj përfitimi, në krahasim me dëmin.

Këto studime mund ta ndryshonin shumë gjykimin e vendimmarrjes që në fazën e hershme, për të parandaluar dhënien pa kriter. Të gjitha këto, sot janë kosto, si anulimet, si vazhdimi i tyre. Pra, është një situatë e vështirë.

Në shumë lumenj ka specie të mbrojtura në rang ndërkombëtar, të cilat janë pjesë e konventave të nënshkruara nga ana jonë, që duhej të mbroheshin nga shteti pikërisht me mosdhënien e disa prej hidrocentraleve, siç është lugina e lumit të Bënçës, që përveç troftës dhe mustakut të rrallë, mostra e të cilëve ruhet në Vjenë, sepse është në zhdukje, ndërsa një mostër tjetër ruhet këtu, në Universitetin Bujqësor, pjesa tjetër është në zhdukje. Janë dhënë pesë hidrocentrale me një fuqi shumë të vogël prodhimi, të cilët përveçse devijojnë rrjedhën e lumit nga Vjosa në Drino, me tubacion e me tunel, marrin edhe ujin e kanionit të famshëm, i cili është mbi 200 metra i thellë, njëkohësisht më i thelli në Ballkan. Eksplorohet vetëm nga të huajt, sepse duhen mjete alpinistësh për të eksploruar. Kanionit i merret uji në hyrje, devijohet komplet dhe shkarkohet në dalje. Pra, kanioni del krejt jashtë funksionit.

Përveç monumenteve të kulturës, që janë urë apo akuadukte të ndërtuara që në kohën e Ali Pashës, të cilat në momentin që nuk kanë ujin poshtë humbasin vlerën e tyre turistike.

Unë jam në dijeni edhe të Valbonës, sepse për shkak të profesionit udhëtojmë e inspektojmë shumë zona, të h/c-ve të Setës, të Langaricës, si dhe të shumë zonave të tjera, të cilat janë shumë të ngjashme në lidhje me problematikën.

Tani, për t'iu kthyer dhe një herë studimit të mirëfilltë, të studimi janë edhe ndikimet në mjedisin social, përveç atyre natyrorë. Po flasim për peshqit, po flasim për pemët, por nuk flasim për banorët e këtyre zonave.

Janë ca njerëz, të cilët rrojnë dhe nxjerrin bukën e gojës me shumë mundim. Të ardhurat e tyre janë kryesisht nga blegtoria e bujqësia, dhe direkt apo indirekt ndikohen nga ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

Një aspekt tjetër janë bimët mjekësore, të cilat janë ndër të paktat produkte që ne eksportojmë, të cilat në një biodiversitet, në një habitat, në një zonë pyjore ku ndryshon mikroklima, me kalimin e kohës fillon edhe degradimi i bimësisë. Zhdukja e këtyre bimëve mjekësore ndodh pjesërisht nga shfrytëzimi pa kritere e pjesërisht nga ndryshimi i mikroklimës.

Një efekt tjetër është edhe erozioni. Ndërtimi i këtyre hidrocentraleve në seri, duke e devijuar rrjedhën që nga degët e sipërme e deri te grykëderdhja në det, ndikojnë negativisht, indirekt por me pasoja afatgjata, edhe në prurjet inerte, që depozitohen në deltat e lumenjve. Prurja e inerteve në deltat e lumenjve është e rëndësishme për të frenuar edhe erozionin bregdetar, për të parandaluar përmytjet, të cilat ndikohen edhe nga ngrohja e klimës globale; është një faktor që i shtohet kësaj, dhe rritet niveli i detit. Por duke pasur edhe mungesë të inerteve aty, fillon edhe përmytja në zonat e cekëta.

Një faktor tjetër negativ është shfrytëzimi i inerteve, që bëhet pengesë që të mos shkojë as edhe një kokërr rëre buzë detit. Përveç kësaj, në procesin e tyre natyror lumenjtë kanë edhe tokëformimin. Pra, vetë natyra, planeti ynë funksionon në mënyrë të tillë, që nëpërmjet erozionit të lumenjve dhe prurjeve që sjellin në shtretërit e tyre krijojnë edhe tokat bujqësore. Po të vëmë re, tokat më pjellore janë buzë lumenjve. Ato janë toka aluvione, që i ka sjellë lumi, dhe sot janë nga tokat bujqësore më pjellore.

Në një afat shumëvjeçar, po themi, mbase edhe njëqindvjeçar, do të hasemi edhe me këtë problem: që nuk do të kemi më prodhim të tokave bujqësore, rinovim, rigjenerim të tokës, që kërkon miliona vjet, sepse erozioni do të bëjë që ato toka t'i humbim pjesërisht.

Shkurt, ndikimi në shëndet shtrihet në të gjitha komunitetet e këtyre zonave; në momentin që humbet vlera turistike, bujqësore e blegtorale, ata detyrohen të shpërngulen.

Kaq kisha.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit!

Zonja Spiropali.

Elisa Spiropali – Faleminderit për prezantimin tuaj, si dhe për pasionin me të cilin e bëni punën tuaj.

Kur po ju dëgjoja, pata një si keqardhje të madhe, e po lexoje dhe për librat; duke qenë se ne të gjithë jemi rritur me këtë natyrë, se nuk është se kemi pasur forma të tjera argëtimi, vajtja nëpër këto vende kaq të veçanta na zgjojnë edhe ne kujtime fëmijërie, por edhe kujtime të kësaj kohe.

Unë dua të di nëse këtë që po prezantoni sot, në këtë komision, pra të gjitha gjetjet tuaja, a ia keni prezantuar ministrit të Mjedisit dhe Turizmit e ministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës? A keni marrë një përgjigje me gojë a me shkrim, ndonjë studim të tyre apo ndonjë ndërhyrje, që ministri i Mjedisit ka bërë për këtë çështje? Pra, a jeni ju në komunikim të vazhdueshëm me këta autoritete, për sa i përket këndvështrimit tuaj, gjetjeve tuaja?

Sazan Guri – Të falënderoj për pyetjen, zonja deputete, sepse është shumë e drejtë.

Në fakt, këtë marrëdhënie e kemi prej vitesh, dhe e kemi me shumë grupe, qofshin vendimmarrës e politikëbërës. Madje edhe me kompanitë, deri në procese gjyqësore. I kemi përdorur të gjithë elementet. Në rastin konkret jemi me ministrin e Mjedisit, zotin Blendi Klosi, sapo e parashtruam, ndërkohë e kemi parashtruar edhe më herët, dhe kemi mirëkuptim të plotë.

Në rastin e Osumit ishte ky ministër, por ndoshta Osumi ishte më i lobuar si *rafting*, si procese turistike ishte më i lobuar, ndaj edhe Kryeministri, edhe ministri zoti Klosi, e vendosën menjëherë mosprekjen e tij. Por edhe sa u takon lumenjve të tjerë, me zotin Klosi jemi në një mirëkuptim e bashkëpunim shumë të mirë. Sot, në ditën ndërkombëtare të mjedisit, iu drejtuam me mesazhe zotit Klosit, që t'i përcillte në qeveri e në bashki, mesazhe shumë pozitive, por në pikëpamje teknike.

Me zotin Gjijknuri kemi probleme, sepse në takimin me zëvendësministrat përkatës, që mbulojnë energjetikën, shprehja e zonjës zëvendësministre ishte: “Ne duam sa më shumë energji” dhe nuk pyeste fare për këtë bashkëbisedim që po bëjmë ne tani, së bashku. “Ne duam energji”, thoshte. S’kuptonte ç’është ekosistemi. S’kuptonte ose bënte sikur s’kuptonte, sepse dukej se ishte e mirinformuar si tekniciene, se fatmirësisht ishte inxhinierë. Thoshte: “merruni me mjedisin!”. Kjo ishte përcjellja që na bëri.

Zotin Gjijknuri e takuam edhe sot në mëngjes. I thamë: “merr pjesë te ky kuvend që po bëjmë në natyrë!”. Kuvend në natyrë bëmë sot, nga ora 9 deri në 9. 50. Edhe ministri Gjijknuri është në një linjë me zëvendësministren e vet. Siç më thanë, ka premtuar se në Vlorë nuk do të bëhen këto H/C. Ndërkohë, me ne ka letra, por nuk ka përgjigje. Ka libra, ka letra, rezoluta. Ne kemi bërë me dhjetëra konferenca, me djersën tonë. Çdo gjë me djersën tonë. Absolutisht asnjëra në kuadrin e ndonjë projekti. Nuk ka absolutisht. Po qenë ca projekte, që bëjnë disa organizata, me

të cilat ne avash-avash do të kemi probleme, sepse mund të quhen talebanë mjedisorë. Sa më shumë lekë që hedhin disa organizata, aq më keq shkon ajo çështje që ata trajtojnë. Ndërsa kauzat tonë janë kauza shpirtërore. Si kauzat fetare, afërsisht. Kauzat tona janë shpirtërore. Të gjithë këta zotërinj që kemi këtu, por edhe shumë të tjerë mbas, janë njerëz që e duan realisht atë që bëjnë ose atë që mbrojnë.

Prandaj kemi nevojë për ju, që ata të na presin e të na dëgjojnë, që zoti Gjiknuri të na dëgjojë. Kaq duam ne.

Petrit Vasili – Në rregull! Besoj se përgjigja është e qartë.

Ndonjë gjë tjetër, a ka?

Po, zonja Rista!

Adelina Rista – Faleminderit! Faktikisht, unë isha shumë e vëmendshme në dëgjesë. Ju falënderoj për informacionin që na dhatë! Them se është shumë i vlefshëm. Kuptohet, unë sot po ju dëgjoj për herë të parë. Kam qenë deputete edhe mandatin e kaluar, ndaj desha t'ju bëja një pyetje: kur ka filluar puna juaj, e të gjithëve bashkë, për sensibilizim, për të pasur ndryshime ligjore? Pranë nesh po vini sot, apo keni qenë në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese edhe mandatin e kaluar? Dua ta di këtë. Kjo për arsye se kam qenë deputete mandatin e kaluar, por sot po ju dëgjoj për herë të parë në lidhje me këtë problem. Sepse, unë për veten time, do të bëja një krahasim. Me këtë që dëgjova krijova një perceptim në lidhje me lumenjtë tanë, dhe mund t'i krahasoja me bregdetin shkatërruar të Durrësit. Ashtu mund t'i krahasoja të shumë nga lumenjtë tanë me H/C përsipër.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Rista!

Besoj se është një gjë, e cila duhet sqaruar që më parë. Zoti Guri, kur e paraqiti këtë kërkesë, paraqiti njëkohësisht edhe një dokumentacion në lidhje me një kërkesë të kahershme që i kishte bërë Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, në mos gaboj edhe Komisionit të Ligjeve, të Ekonomisë, a edhe ndonjë komisioni tjetër. Pra, që prej një kohe të gjatë kishte kërkuar pikërisht organizimin e dëgjesave respektive me të gjitha komisionet e interesuara, për të krijuar sensibilizimin e duhur. Pastaj, secili komision, sipas sferës së kompetencës së veprimtarisë së tij, të shprehej dhe të tregonte gatishmërinë për të pasur atë hapësirë reflektimi, që e lejon edhe praktika legislative këtu, edhe mundësia e nismës ligjvënëse.

Kështu që, unë do t'i korrigjoja, zotin Guri dhe zotin Tola. Kjo dëgjesë është falë të gjithë anëtarëve të komisionit, të cilët, që të gjithë, e kanë mbështetur pa hezitim mbajtjen e saj. Kjo është

për meritën e tyre. Unë thjesht kam bërë paraqitjen në komision të kësaj kërkesë, e cila është pritur me dashamirësi nga të gjithë anëtarët e komisionit. Falë tyre, kjo dëgjese u zhvillua sot.

Unë shpresoj që kjo të jetë edhe një shtysë e mirë pozitive, që edhe komisionet e tjera ta kryejnë këtë gjë, pasi është shumë e qartë se të gjithë ne, jo vetëm thjesht e vetëm pasurojmë njohjen tonë për gjërat, por dhe krijohen ndjeshmëri të tjera, më të forta, krijohen aleanca mes deputetëve në kuptimin më të mirë të fjalës; duke u njohur në mënyrë më të thelluar me informacionet, zhvillojnë ndjeshmëri të tjera. Kështu, besoj se nga çdo dëgjese, një kauzë pozitive fiton miq të ri. Nuk humbet asgjë.

Sinqerisht, nuk e kuptoj arsyen e hezitimit të kolegëve nga komisione të tjera, për t'i kryer këto dëgjese, por them se dita e sotme është një ditë e mirë, meqenëse kjo ndodh në Ditën Botërore të Mjedisit.

Mund të jemi shumë të qetë, se nuk kemi bërë ndonjë gabim sot, por në një rrafsh kohor afatgjatë, brezni të tërë do t'i vuajnë pasojat e këtyre gjërave. Besoj se kjo lloj ndërgjegje nuk duhet të na lërë të qetë, pasi të gjithë ne këtu detyrohemi të marrim vendime, të miratojmë ligje apo nisma, efektin e të cilave, të sharat për këtë gjë mund t'i dëgjojmë pas shumë vitesh. Edhe nëse s'do të jemi në këtë dynja, prapë është një gjynah që nuk lahet.

Keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Po.

Sazan Guri – Në përgjigje të pyetjes së zonjës deputete, ne kemi filluar në 2012-ën, me mbrojtjen e dy lumenjve: Radika e Vjosa, që në fakt kishin të bënin me kufijtë jashtë territorit tonë. Aty kuptuam çfarë po ndodhte me lumenjtë tanë. Konferenca e parë është më 10. 10. 2014, me profesor Farudin Hoxhën dhe shumë të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te juve kemi ardhur në komisionin e zotit Jemin Gjana. Pastaj kemi ardhur te zoti Eduard Shalsi, më 30 dhjetor të 2014-ës, ku pata rastin të isha me pesë profesorë. Andej ishte zoti Genci. Shumë pak vetë ishin, se ishte 30 dhjetor. ne kemi bërë një bisedë dhe një debat frytdhënës, që pastaj nuk vazhdoi më.

Tashti kuptuam se çfarë po ndodhte, sepse u kaluan caqet. Jemi përgatitur shumë mirë për ta mbrojtur deri në Strasburg këtë situatë, por çështja është: pse të mos e ndreqim vetë? Kjo është ideja.

Pastaj ishte konferenca kombëtare, në dhjetor të 2017-ës, pastaj kemi 6 muaj që u lutemi komisioneve. Ju, me të drejtë, na pritët dhe mbase jeni ogur i mbarë.

(Diskutime pa mikrofon)

... në komisionin e zotit Shalsi kemi bërë dëgjese më 30 dhjetor. Ndërkohë, aty u shpreh zoti Ruli dhe tha se nuk thuhet “ndalohen HEC-et”, pastaj ne vramë mendjen dhe pamë se ndalohen me dhjetëra elemente, që ndërtojnë HEC-et.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilia Kondi - Faleminderit!

Unë jam Ilia Kondi me profesion avokat. Kam rreth 15 vjet që ndjek kauzat sociale, problematikat që kanë ato. Gjithnjë solidarizohem me këto problematika, duke i parë edhe në këndvështrim ligjor, pse jo, edhe duke i ndjekur ato.

Së pari, doja të theksoja, përpos Ditës së Mjedisit që është sot, edhe një debati këtu në komision, që e vlerësoj më shumë edhe në aspektin doktrinar, rrugën e zgjidhjes së problemeve që kanë lumenjtë shqiptarë. Dua t’ju bëj me dije se edhe Parlamenti European në rezolutat e tij ka ngritur zërin, partitë e gjelbra europiane veçanërisht, gjithnjë për të mbrojtur natyrën shqiptare dhe lumenjtë shqiptarë, madje është propozuar në rezoluta specifike, që duhet të mbrohen në mënyrë eksplicite disa raste, midis tyre edhe rasti i lumit Vjosa, që njëri prej deputetëve e përmendi si një eksperiencë të mëparshme.

Gjithashtu, dua të bëj me dije se jo vetëm ne duhet të japim informacion në komisione, por edhe deputetët duhet të sensibilizohen. Janë vetë deputetët në terren, i shohin shumë mirë problematikat, e kanë për detyrë të ngrenë edhe ato problematika. Nga ana tjetër, komisionet parlamentare duhet t’i ftojnë ministrat dhe pse jo të merren masa konkrete.

Zoti Vasili, siç na bëtë një pyetje ju, edhe unë do të shtroja një pyetje për të gjithë ne, pse jo, edhe për kolegët e mi: Çfarë bëhet pas kësaj dëgjese? Çfarë mase konkrete marrin këto komisione? A i bashkërendojnë punët Komisioni i Mjedisit, Komisioni i Ligjeve, Komisioni i Shëndetësisë dhe komisione të tjera, që të gjithë në koherencë me njëri-tjetrin, si dhe me ministrinë e linjës të marrin të gjitha masat, për këtë gangrenë të madhe të HEC-eve shqiptare, që, të paktën, atje ku nuk ka vend për ndërhyrje, të mos ndërhyhet, por atje ku ka vend për ndërhyrje, të parandalohet?

Më konkretisht është rasti i Langaricës, ku i gjithë lumi është devijuar në tub, e përmendën kolegët, dhe pasojat janë shumë të mëdha. Kjo zonë nuk ka energji elektrike. Minimumi, që mund të bënte ky HEC për këtë komunitet në Përmet, ishte të restauronte linjat e vjetra të energjisë eklektike, që janë të vitit ’69 dhe e gjithë energjia kalon në shtetin grek.

Nga ana tjetër, pa diskutim pasojat janë edhe për plazhin, peshkun, kanionin e të tjera, sa edhe një turist i huaj që ka ardhur tek ujërat termale, midis dhjetëra turistëve, kur ka parë këtë krim të madh mjedisor, ka thënë: Ju po bëni një pallat në mes të Koloseut”.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se ka një problematikë të madhe, por çështja është se si do të ecim dhe si do të procedojmë me veprime konkrete, veçanërisht nga komisionet parlamentare.

Ne kemi qenë përballë rasteve, sepse kjo e “keqe e madhe” na vjen nga ministritë, shpeshherë nga vendimmarrja e gabuar e qeverive ndër vite.

Ne i kemi bërë shkresë të qartë ministrit të Mjedisit, në lidhje me anulimin e HEC-it në Langaricë, kur ishte në ndërtim e sipër. Çfarë ndodhi?

Ka pasur një leje mjedisore, që është bërë në kundërshtim me VKM-në, sepse është zonë e mbrojtur me ligj dhe një leje që nuk i jepej, pra refuzohej dhënia e lejes koncesionarit. Pas dy javësh është dhënë një leje, ku thuhej se s’ka problem edhe mund të ndërtohej.

Pra, problemi është se përpos shkeljes së rezolutave dhe konventave, këtu shkelet në mënyrë të hapur edhe ligji që kemi. Pra, me VKM që janë shpallur zona të mbrojtura me ligj edhe këto territore ku kalojnë basenet e ujërave dhe aty vazhdojnë të ndërtohen HEC-e, për më tepër kërcënohen të ndërtohen HEC-e.

Le të jemi konkretë dhe të mos fshihemi pas gishtit! Ky është propozimi im.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit!

Urdhëroni!

Adelina Rista – Kam një pyetje nga ana teknike. Faktikisht, lejen për ndërtimin e këtyre HEC-eve duhet ta japë ministria. Shumë nga këto HEC-e, pa marrë lejen nga basenet pranë prefekturave për përdorimin e ujit, nuk duhet të marrin lejen e ndërtimit të HEC-it. Shumë nga këto HEC-e janë ndërtuar duke bërë lidhje të shkurtër, pa marrë lejen e përdorimit të ujit pranë këshillit të basenit ujqor që funksionon pranë prefekturave.

A quhen ndërtime pa leje këto HEC-e, sepse i mungon leja e përdorimit të ujit?

(Diskutime pa mikrofon)

Sazan Guri – Nëse me lejoni, zoti kryetar, po jap një përgjigje të shkurtër.

Situata është e tillë, zonja deputete, që HEC-et i nënshtrohen një projekti, ku lejen fillestare e merr nga shumë institucione publike, si: nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, që asnjëherë nuk ka kundërshtuar, ose të ketë bërë potencialet strategjike, se sa lejohet, sa është i aftë

të prodhojë energji çdo lum, çdo përrua, çdo rrëke. Këtë s'e ka bërë kurrë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Duke qenë se e merr AKBN-ja, ndërkohë edhe ministria e linjës e jep këtë leje dhe përgatiten disa vlerësime ndikimesh në mjedis nga ekspertë të caktuar që i paguan kompania. Gabimet këtu janë që në përgjithësi duke qenë se merr një sasi të madhe ujore, jo 20 milionë metër kub në vit, por 100 milionë, të gjitha raportet duhet të ishin të thelluara. Kjo do të thotë që t'i nënshtrohesh një procesi të takimit me publikun.

Në këtë proces takimet me publikun janë formale, për shembull, nëse diskutohet HEC-i i Bënçës, mbledhja është bërë në Fier, në qoftë se diskutohet HEC-i i Lurës, mbledhja është bërë në Tiranë, në qoftë se diskutohet HEC-i në Valbonë, mbledhja është bërë me tropojanë të ikur në Tiranë. Pra, edhe në rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit në lokalitetet përkatëse, ta zëmë në Dibër, ka dhënë mosaprovim, ose ka dhënë objeksion, ka qenë kundër ndërtimit të HEC-it në Cem apo në Valbonë, edhe në këto raste nuk është marrë parasysh mendimi i tyre.

Atëherë kemi herë-herë falsifikime, herë-herë mashtrime nga institucione publike, me të cilat ne sot jemi në gjyq, pikërisht për falsifikimet publike që ka bërë vetë institucioni, që e merr një koordinatë dhe e çon 5 km më tutje, që merr 10 firma, u thotë se do t'u sjell çokollata të zeza për fëmijë dhe ndërtojnë diçka që shkatërron tokën. Pastaj shkojnë te KKT-ja, ku marrin leje me kusht. KKT-ja është një institucion që këta e mbërthejnë nga poshtë me firma herë-herë të falsifikuara, me denigrime konceptesh teknikienësh.

Ne duam ballafaqim me ministrin e Energjetikës, me AGBN-në e të tjerë. Kjo është situata.

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Guri!

Mustafa Tola – Në përgjigje të pyetjes, praktika e ndjekur është e tillë:

Së pari, duhet të ishte marrë leja mjedisore dhe leja e basenit përkatës.

Në fazën e miratimit të projektit në maj të vitit 2015 është refuzuar leja mjedisore dhe nuk është marrë leja e basenit të ujërave përkatëse.

Në shtator të vitit 2015, KRT-ja e Republikës së Shqipërisë ka miratuar projektin, pa leje mjedisore dhe pa lejen e basenit të ujërave përkatëse.

Në vendimet e KRT-së së Republikës është vënë kusht pika nr.2: “Të pajiset me lejen e basenit uJOR përkatës dhe pastaj të jepet leja”. Ky ka qenë kushti.

Çfarë ka ndodhur më pas? Nuk është marrë leja nga baseni uJOR përkatës që është pikërisht Drin-Bunë, por është dhënë leje nga Këshilli Kombëtar i Ujit, një instancë më e lartë. Pra, është

shkelur kompetenca, ka qenë një leje e detyruar dhe nuk është më nga baseni përkatës, por nga një instancë më e lartë.

Çfarë ka ndodhur tjetër? Leja e mjedisit, në vend që t'i nënshtrohej një vendimmarrjeje të shtjelluar, i është nënshtuar një vendimmarrjeje të thjeshtë, dhe kjo pasi është marrë vendimi i KRT-së së Republikës.

Pra që të gjitha këto bien ndesh me ligjin. Ne jeni në proces gjyqësor me të gjitha agjencitë dhe me KRT-në e Republikës.

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Tola!

Mendoj se u shteruan të gjitha problematikat.

Faleminderit, të ftuarve për pjesëmarrjen!

Gjithçka që diskutuam së bashku, ashtu sikur është në praktikën e komisionit tonë, do të zbardhet dhe në mënyrë të veçantë të gjitha shqetësimet më kryesore dhe patjetër që do t'i përcillen qeverisë, gjithashtu ministrive që janë drejtpërdrejt të interesuara. Në rast se ju, ndërkohë, keni edhe gjëra akoma më konkrete, të cilat doni t'i ripërcjellim për të tërhequr vëmendjen si fakte konkrete, ne ju jemi mirënjohës, pasi detyra jonë është, në radhë të parë, të tregojmë një sensibilitet shumë të lartë.

Në rast se do të ketë nga ju nisma konkrete të karakterit ligjor për ndryshime përkatëse, bëjini! Në këtë rast kuptohet se nuk ecet më të njëjtat ndjeshmëri, se ndjeshmëria juaj është më e lartë edhe në pikëpamje shoqërore, edhe shkencore, pse jo, s'kemi pse të kemi frikë nga kjo fjalë.

Unë jam i bindur se ne do të jemi mbështetës të mirë të nismave tuaja, edhe për çka mund të duhen ndryshime për mënyrë se si trajtohen koncesionet e veprave energjetike, si duhet të paraprijë analiza mjedisore, si duhet të paraprijë analiza e ndikimeve eventuale mbi shëndetin, se jemi koshtientë që analiza e ndikimit të mjedisit është një komponent, por lidhja e saj me ndikimin në shëndet të jeni të bindur që i jep fuqi më të madhe edhe argumentimit, edhe ndjeshmërisë publike.

Ju falënderoj edhe një herë që ishit prezentë!

Falënderoj edhe të gjithë kolegët për pjesëmarrjen, durimin dhe aktivizimin tyre!

MBYLLET MBLEDHJA